URDHËR
Nr. 524, datë 10.7.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Adana	Kozan*	
Adana	Aladağ*	
Malatya	Arguvan*	
Karaman	Merkez*	
Izmir	Dikili*	
Kars	Kağızman*	
Hakkari	Merkez*	
Aydin	Sultanhisar*	
Çankiri	Çerkeş*	
Ankara	Bala*	
Ankara	Polatlı*	
Afyon	Sandıklı*	
Aksaray	Merkez*	
Balikesir	Bandırma*	
Bursa	Gemlik*	
Erzurum	Tekman*	
Erzincan	Tercan*	
Isparta	Uluborlu*	
Karabük	Eflani*	
Giresun	Yağlıdere*	
Rize	Çamlıhemşin*	
Tokat	Zile*	
Usak	Merkez*	
Aydin	Köşk*	
Çorum	Kargı*	
Erzincan	Merkez*	
Eskisehir	Beylikova*	
Kütahya	Tavşanlı*	
Bursa	Orhangazi*	
Çanakkale	Lapseki*	

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Turqisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment, ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjapeve dhe deshve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Urdhri nr. 443, datë 13.6.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj